



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI KONKURENCËS

Nr. 604/prot.
14

Tiranë, më 06.12.2024

VENDIM

Nr. 1135, Datë 06.12.2024

“MBI ANULIMIN E VENDIMIT TË KOMISIONIT TË KONKURENCËS NR. 1125, DATË 07.11.2024 “MBI PËRQENDRIMIN E REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË ENMA INVEST SHPK NGA SHOQËRIA SEASIDE RESIDENCE V SHPK””

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 06. 12. 2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Anulimi i vendimit nr. 1125, datë 07.11.2024 “Mbi përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë ENMA Invest SHPK nga shoqëria SEASIDE RESIDENCE V SHPK”.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, “Mbi revokimin e kontratës datë 21.08.2024 nga shoqëria Seaside Residence V SHPK”,

VËREN SE :

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 24, shkronja d dhe neni 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, me vendimin nr. 1125, datë 07.11.2024 “ Mbi përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë ENMA Invest SHPK nga shoqëria SEASIDE RESIDENCE V SHPK”, ka autorizuar transaksionin e ndryshimit të kontrollit të shoqërisë ENMA Invest SHPK.

Referuar neni 3, pika 4 të “Kontratë Shitje Kuotash e Shoqërisë ENMA INVEST SHPK”, palët kanë rënë dakord se shitësi humbet pronësinë në lidhje me kuotën që është objekt i kësaj kontrate, por kuota do të mbetet e bllokuar në favor të tij deri në shlyerjen tërësisht të çmimit si dhe detyrimet e shoqërisë ndaj palëve të treta.

Me shkresën nr. 601/12 prot. i AK, datë 20.11.2024 “Kërkesë”, shoqëria Seaside Residence V SHPK ka njoftuar pranë Autoritetit të Konkurrencës se kontrata e shitjes së kuotave të shoqërisë ENMA Invest SHPK, e datës 21 gusht 2024, nuk është realizuar, duke kërkuar revokimin e Autorizimit lidhur me transaksionin e përfuturit të kontrollit të vetëm të shoqërisë ENMA Invest SHPK, nga shoqëria SEASIDE RESIDENCE V SHPK.

Nga informacioni i depozituar, u konstatua se gjatë procesit të zbatimit të kontratës së mësipërme, palët pjesëmarrëse në transaksion, TBC Distribucion SHPK dhe SEASIDE RESIDENCE V SHPK, kanë nënshkruar më datë 30 Tetor 2024 dokumentin “Revokim Kontrate Shitje Kuote të shoqërisë ENMA Invest SHPK. Palët kanë rënë dakord midis tyre, që të deklarojnë me marrëveshje e me vullnet të lirë, të revokojnë Kontratën e Shitjes së Kuotës së Shoqërisë ENMA Invest SHPK, datë 21 gusht 2024.

Komisioni i Konkurrencës konstaton se ndodhet përpara faktit të anulimit të kontratës së shitjes së kuotave të shoqërisë ENMA INVEST SHPK, datë 21 gusht 2024, e cila aktualisht ka humbur të gjitha efektet e saj financiare dhe juridike, si për palët nënshkruese edhe për palët e treta.

Neni 113 i ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës Së Shqipërisë”, parashikon se një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë të nxjerrë aktin.... dhe sipas nenit 117, anulimi ose shfuqizimi mund të bëhet brenda 30 ditëve nga dita kur organi publik është njohur me faktet që çojnë në anulimin ose shfuqizimin, por jo me vonë se 5 vjet nga njoftimi i aktit administrativ.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; neni 113 i ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Të anulohet vendimit e Komisionit të Konkurrencës nr. 1125, datë 07.11.2024 “Mbi përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfuturit të kontrollit të shoqërisë ENMA Invest SHPK nga shoqëria SEASIDE RESIDENCE V SHPK”.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS


Leida MATJA

()
Zv/Kryetar


Rezana KONOMI

()
Anëtar

Durim KRAJA

()
Anëtar

Fatjola DELIJA

()
Anëtar

Denar BIBA

()
Kryetar

